



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Nr. 36/7 Prot.

Tiranë, më 30/09/2017

V E N D I M
Nr. 142, Datë 30/09/2017

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË
PERFORMANCËS, “EFEKTIVITETI I MASAVE TË NDËRMARRA NGA
ORGANET TATIMORE NË MBLEDHJEN E DETYRIMEVE TË
PAPAGUARA TË SUBJEKTEVE TATIMPAGUESE”

Në zbatim të planit vjetor 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit nr. 36/1 datë 03.04.2017 të miratuar të auditimit, ndërmori auditimin e performancës me temë: **“Efektiviteti i masave të ndërmarra nga Organet Tatimore në mbledhjen e detyrimeve të papaguara të subjekteve tatimpaguese”**.

Ky auditim u programua për t’u ushtruar në subjektet: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, subjektet në varësi të saj, Drejtoritë Rajonale Tatimore, duke u shtrirë në Ministrinë e Financave, DPD, QKB, ZQRPP, ISSH që kanë detyrim zbatimin e masave shtrënguese të kërkuara nga Administrata Tatimore Qendrore (ATQ); duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me efektivitetin e funksioneve menaxhuese, monitoruese dhe performancën e strukturave të DPT dhe DRT-ve, etj.

Në këtë auditim fokusi ishte analiza e performances së veprimtarisë së organeve qendrore tatimore në drejtim të menaxhimit të detyrimeve të papaguara, me qëllim që kjo veprimtari të ketë efektivitet të lartë dhe që buxheti i shtetit dhe në tërësi shoqëria të përfitojë fondet e parashikuara nga dispozitat ligjore përkatëse. Në këtë mënyrë, objekti i këtij auditimi ishte pasqyrimi i nivelit në të cilën ndodhen detyrimet e papaguara tatimore në vendin tonë, duke analizuar faktorët që kanë ndikuar në krijimin e këtyre detyrimeve, vlerësimin e veprimtarisë së organeve tatimore qendrore dhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore për të garantuar arkëtimin e detyrimeve të papaguara në buxhetin e shtetit.

Mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara, është funksion i rëndësishëm i punës së Administratës Tatimore Qendrore (ATQ), që mbështetet nga legjislacioni tatimor dhe ndikon në realizimin e të ardhurave.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në vitet e fundit, ka bërë progres të mirë në zbatimin e praktikave moderne të administrimit të tatimeve. Është vënë në zbatim një sistem i ri i teknologjisë së informacionit (IT).

Nga auditimi u konstatua se, sistemi tatimor C@TS ka nevojë për përmirësim në drejtim të gjenerimit të treguesve të mbledhjes me forcë për të krijuar mundësinë e përgatitjes së informacionit sipas kërkesave dhe specifikave të strukturave të mbledhjes me forcë(*trajtuar në faqet nr. 47 të Raportit të Auditimit*).

Dobësia kryesore në punën e ATQ janë rezultatet e dobëta në mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat dhe ritmet e shpejta të rritjes së tyre kanë bërë që detyrimet e papaguara tatimore në afat të arrijnë nivelin më të lartë në historinë e veprimtarisë së organeve tatimore.

Mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat, është drejtimi më i vështirë i punës së organeve tatimore. Peshën më të madhe në krijimin e detyrimeve të papaguara e zënë detyrimet e akumuluar nga njoftim-vlerësimet e kontroleve tatimore, vlerësimeve të bëra për tatimpaguesit, verifikimet në terren, gjobat dhe interesat e llogaritura automatikisht nga sistemi informatik.

Përveç kërkesave të Rregullores, Manualit të Auditimit të Performancës së KLSH-së, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit - ISSAI, janë kërkuar dhe shfrytëzuar materiale të ndryshme: Plane strategjike dhe studime përkatëse të subjekteve ku është shtrirë auditimi, artikuj të medias së shkruar, konkluzione të informacioneve që lidhen me problemin e menaxhimit të detyrimeve tatimore të papaguara në afat, studime dhe raporte të organizatave ndërkombëtarëve, etj.

Pas përfundimit të punës paraprake audituese me shkresën nr. 36/1 datë 03.04.2017 u dërgua Programi i Auditimit të Performancës. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr 36/2, datë 03.06.2017 iu dërgua Projekt-Raporti i auditimit subjekteve të audituara. Raporti përfundimtar është hartuar pasi janë shqyrtuar komentet dhe shpjegimet e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 13152 prot. datë 03.07.2017, si dhe pas konsultimeve me palët e interesit.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

K O N K L U D O V A:

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore

Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fund të vitit 2016 është **147 068 milionë lekë** dhe paraqitet me një rritje e ndjeshme, në masën 45.5 %, krahasuar me një vit më parë, ndërsa të ardhurat gjithsej të realizuara nga DPT për këtë vit janë 214.6 miliardë lekë. Gjatë v. 2016, ATQ ka pësuar një shtim rekord të detyrimeve tatimore të papaguara në afat, tregues ky i menaxhimit jo të mirë të këtyre detyrimeve nga administrata tatimore. Në vlerën e detyrimeve të papaguara prej 146 068 milion lekë është e përfshirë edhe vlera prej 37 338 milion lekë e 541 subjekteve që janë në proces gjyqësor. Ndërsa krahasuar me v. 2011 gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të v. 2016 është 2.2 herë më e madhe.

Përveç shtimit të detyrimeve të papaguara në vlerë kemi edhe rritje të ndjeshme të numrit të bizneseve të cilat kanë këto detyrime; në fund të vitit 2016 numri i këtyre bizneseve arriti në 146,650 nga 79,785 që ishin në vitin 2011, me një shtim rreth 1.8 herë.

Kjo shifër bëhet më shqetësuese duke patur parasysh se nga të dhënat zyrtare të DPT-së subjektet tatimpagues aktive në fund të periudhës janë rreth 108 mijë, pra një numër shumë më i vogël se subjektet me detyrime të papaguara.

Funksioni i mbledhjes me forcë kryhet nga 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore, nga të cilat në 7 prej tyre, mbledhja me forcë është organizuar si drejtori dhe në 7 DRT si sektor.

Nisur nga gjendja e detyrimeve të papaguara sipas statusit të tatimpagues konstatohet se subjektet e evidentuara si pasive, të cilat nuk ushtrojnë aktivitet ekonomik prej një kohe të gjatë, zënë rreth 37 %, peshë e madhe kjo në gjendjen e këtyre detyrimeve dhe që mundësitë për t'i mbledhur këto detyrime janë shumë të vogla, duke e kthyer këtë në një borxh të pambledhshëm.

Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat në fund të periudhës (2016) përbëhet kryesisht nga detyrimet tatimore të lindura nga 2-5 vite me një peshë prej 58 % të totalit të borxhit, gjë që tregon se sasi të mëdha detyrimeve tatimore të papaguara janë të pambledhshme, për të cilat DPT-së tashmë e ka praktikisht të vështirë të ndërmarre veprime të mëtejshme ligjore për mbledhjen e detyrimit me forcë. Kështu vleftha e masës detyrimeve tatimore të papaguara është rritur së tepërmi, duke sjellë si pasojë nevojën e veprimeve spastruese, siç ka qenë ligji i faljes i zbatuar në v. 2011 (nga zbatimi i këtij ligji, rezultoi se deri në fund të vitit 2013, janë falur 362.455 raste me vlerë 29.8 miliardë lekë) dhe ligji i ri i miratuar tashmë nga Kuvendi dhe që ka hyrë në fuqi me 06.05.2017, për faljen e detyrimeve tatimore e doganore të prapambetura.

Pesha e madhe e borxhit të vjetër, si në numër rastesh dhe në vlerë, flet për një nivel të lartë të “zonës së riskut” të borxhit, gjë që rrit pamundësinë e arkëtueshmërisë së tij. Niveli i kësaj zone ulët vetëm me marrjen paraprake të masave shtrënguese, në kohë dhe të sakta, të cilat duhet ti referohen më shumë borxhit të vjetër.

Ndërsa vlera e detyrimeve me vjetërsi deri në 2 vjet, **e cila përbën 41% të gjendjes**, është me risk më të ulët dhe më e mundshme për t'u mbledhur nga ana e administratës tatimore qendrore. Nga auditimi u konstatua se nuk është zbatuar nga strukturat e mbledhjes me forcë të Administratës Tatimore Qendrore kriteri ligjor i evidentimit të detyrimeve të papaguara tatimore, të pambledhshme, si dhe në asnjë rast nuk ka patur kërkesa pranë drejtorive rajonale tatimore nga subjektet tatimpagues për shpalljen e detyrimit tatimor të pambledhshëm dhe si rrjedhojë sektorët e mbledhjes me forcë nuk kanë zbatuar praktika të tilla për shpalljen e detyrimit tatimor të pambledhshëm.

Nga auditimi i ushtruar në terren, përgjigjet e pyetësorëve të stafit të ATQ dhe nga intervistat e zhvilluara me specialistët e mbledhjes me forcë rezultoi se konsumohen shumë burime njerëzore dhe kohë, duke bërë shumë procedura, mijëra njoftime që duhet të bëhen nga specialistët e borxhit në DRT për subjektet, duke qenë se pothuaj të gjitha DRT kanë më shumë subjekte me detyrime të papaguara se sa subjekte të regjistruara, gjë që ka ndikuar edhe në efektivitetin e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara.

Sistemi i ri elektronik tatimor C@TS i vënë në zbatim në v. 2015 në të gjithë ATQ nuk është plotësisht i përshtatshëm për punën e përditshme të personelit të mbledhjes me forcë. Ky sistem punon me data dhe jo me periudha tatimore, pra në rastin e arkëtimit të cilat bëhen nga tatimpaguesit për detyrimet në kohë reale apo të lindura rishtazi, këto arkëtime mbyllin borxhet e prapambetura (ku përfshihen dhe detyrimet për të cilat subjekti mund të jetë në proces gjyqësor, në apelim dhe në akt - marrëveshje) dhe njëkohësisht nuk mbyllin detyrimet koherente, të cilat në vazhdimësi gjenerojnë gjoha dhe interesa. Është e pamundur të nxirren nga sistemi tregues sintetikë të cilët do t'i shërbenin hartimit të raporteve menaxherial nga drejtuesit e strukturave të mbledhjes me forcë.

Mbikëqyrja e proceseve të punës nga drejtuesit në tërësi është e dobët, çka rezultoi në faktin se, për të siguruar arritjen efektive dhe graduale të objektivave të punës ndërhyhet pak nga ana e drejtimit. Mungesa e të dhënave operacionale esenciale dhe e raporteve të drejtimit është faktor

që ka ndikuar në këtë situatë. Kjo tregon se në procesin e mbledhjes me forcë të detyrimeve të papaguara në afat nuk ka gjetur zbatim nga DPT, Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Nga të dhënat e dërguara prej Drejtorive Rajonale si dhe nga auditimi i kryer vihet re se masat shtrënguese nuk janë të shtrira në të gjithë fazat e përcaktuara në kuadrin ligjor, por janë mjaftuar vetëm me vendosjen e një mase dhe me tej procedurat janë bërë pjesërisht ose janë ndërprerë (trajtuar në fq. 50, 51 të Raportit të Auditimit).

Arkëtimi i detyrimeve të papaguara nga masat shtrënguese është në total 38.412.306 mijë lekë për periudhën 2011-2016, ku nga këto 13.478.251 mijë lekë janë arkëtuar vetëm në vitin 2016. Në vitin 2015 janë arkëtuar 5.829.107 mijë lekë, në vitin 2014 janë arkëtuar 7.271.986 mijë lekë, në vitin 2013 janë arkëtuar 5.020.027 mijë lekë, në vitin 2012 janë arkëtuar 4.005.977 mijë lekë dhe në vitin 2011 janë arkëtuar 2.806.958 mijë lekë. Nga auditimi rezultoi se për periudhën e viteve 2011 - 2016 për masat shtrënguese janë mbledhur nga 12 deri 31% të vlerës së masave të vendosura.

Nga auditimi rezultoi se nuk ka gjetur zbatim realizimi i procedurës së sekuestrimit e më pas konfiskimit, të pasurisë së paluajtshme, të siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit, për të vijuar më tej, me zbatimin e procedurave të Ankandit Publik dhe të ardhurat e përfituara, të shkonin për likuidimin e detyrimeve tatimore të papaguara nga ana e tatimpaguesit (trajtuar në fq. 55 të Raportit të Auditimit).

Përvoja e vendeve të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)

tregon se autoritetet tatimore duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë parandalimit të krijimit të detyrimeve tatimore të papaguara. Dihet se sa më i vjetër është borxhi tatimor, aq më e vështirë është mbledhja e tij dhe bazuar në rrethanat, gjeneron më pak para.

Për këtë ATQ duhet të ndërtojë strategji të zbatueshme për parandalimin e hershëm të krijimit të borxhit tatimor. Në procesin e mbledhjes së detyrimeve tatimore, administrata tatimore duhet të ndërmarrë masa për të parandaluar krijimin e borxhit tatimor,

- Ritmet e larta të rritjes së detyrimeve tatimore të papaguara në afat dhe zbatimi i pjesshëm i masave shtrënguese të paparashikuara në kuadrin ligjor, tregojnë se këto masa nuk kanë patur rol parandalues në krijimin e këtyre detyrimeve.

- Nga auditimi u konstatua se, administrata tatimore, nuk ka informacion dhe nuk ka bërë analiza të kostos së veprimtarisë së mbledhjes me forcë. Për v. 2016 për strukturat e mbledhjes me forcë në DPT dhe DRT vlerësohet një fond page vjetor të planifikuar prej rreth 136 milion lekësh, shumë e konsiderueshme kjo që flet për një kosto të lartë në mbledhjen e detyrimeve të papaguara tatimore. Duke patur parasysh se këtë vit arkëtimet nga detyrimet e papaguara tatimore ishin 13,478 milionë lekë; për çdo 1 lekë të harxhuar për paga është vjelë 100 lekë borxh tatimor. Tregues shumë i ulët ky krahasuar me vendet e zhvilluara të Europës, ku në Mbretërinë e Bashkuar, treguesi i efektivitetit të kostos së kësaj veprimtarie është në raportin 1/310.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 120 dt. 2.8.2016 si rrjedhojë e ristrukturimit organizativ që po zbatohet për të ndryshuar gjendjen e rëndë të ATQ në drejtim të mbledhjes me forcë, është rritur ndjeshëm nr. i punonjësve në organikë që merren me mbledhjen me forcë, duke zënë kështu 10 % të numrit gjithsej të punonjësve të planifikuar për ATQ.

Bazuar në sa më sipër, KLSH është përpjekur t'i japë përgjigje pyetjes: **“A ka qenë efektive veprimtaria e Organeve Tatimore në menaxhimin dhe marrjen e masave për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara?”**, duke konsideruar veçanërisht kuadrin rregullator e ligjor dhe detyrimet tatimore të papaguara në afat si dhe zbatimin nga ana e strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve e Drejtorive Rajonale Tatimore të kuadrin rregullator e ligjor, duke arritur përfundimisht në këtë mesazh auditimi:

“Administrata Tatimore Qendrore nuk ka arritur të menaxhojë detyrimet tatimore të papaguara në afat dhe të zbatojë me efektivitet masat organizative dhe shtrënguese për grumbullimin e tyre. Kjo evidentohet qartazi në rritjen e konsiderueshme në vlerë dhe në numër të subjekteve me detyrime tatimore të papaguara me vjetërsi mbi 2 vjet, duke ndikuar kështu negativisht në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka mundur të vjelë detyrimet e papaguara nga subjektet tatimpagues, pasi nuk ka krijuar kushtet për zbatimin plotësisht të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me detyrimet tatimore; strukturat e mbledhjes me force nuk kanë zbatuar rregullisht metodën e vlerësimit të riskut dhe nuk kanë kryer monitorimin e kontrollin e duhur ndaj drejtorive rajonale tatimore të kësaj veprimtarie të rëndësishme, për realizimin në praktikë të procedurës së sekuestrimit e më pas konfiskimit ndaj subjekteve tatimpagues me detyrime, si dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore ka qenë i pjesshëm, duke ulur ndjeshëm efektivitetin e veprimtarisë së administratës tatimore qendrore në zbatimin e masave ligjore shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat.”

Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi performance, synojnë të kontribuojnë e të ndihmojnë menaxhimin e Administratës Tatimore Qendrore, në përmirësimin e situatës dhe marrjen e masave konkrete, për grumbullimin e detyrimeve tatimore të papaguara në afat, duke ndikuar kështu pozitivisht edhe në rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

Nisur nga konkluzionet e mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar adresimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij problemi social:

V E N D O S A:

- I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Performancës, **“Efektiviteti i masave të ndërmarra nga Organet Tatimore në mbledhjen e detyrimeve të papaguara të subjekteve tatimpaguese”**, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe të shtrirë edhe në Ministrinë e Financave e Institucione të tjera qendrore.
- II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

A. - Në drejtim të punës së organeve tatimore në menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara nga subjektet tatimpagues:

1. Nga ana e strukturave të mbledhjes me forcë në DPT dhe në DRT të kryhen analiza periodike të thelluara mbi gjendjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat dhe shkaqet e rritjes së saj me ritme të larta si dhe parashikimet për vjeljen e tyre në të ardhmen si dhe ndikimin e tyre në të ardhurat e buxhetit.

Në vijimësi

2. DPT të rishikojë metodologjia e vlerësimit të detyrimeve tatimore të papaguara në afat, duke mos përfshirë në këto detyrime vlerën e çështjeve që janë në proces gjyqësor.

Brenda 10 mujorit 2017

3. Ministria e Financave në bashkëpunim me DPT të hartojë një udhëzim për kriteret e klasifikimit si të pambledhshme dhe rrugët e sistemimit nga strukturat e mbledhjes me forcë në ATQ, në detyrimet tatimore të papaguara në afat.

Brenda vitit 2017

4. Strukturat e mbledhjes me forcë të DPT dhe DRT, të evidentojnë detyrimet tatimore të papaguara në afat të pambledhshme dhe të priorizojnë punën duke vendosur edhe masa të diferencuara shtrënguese për afate të ndryshme të vjetërsisë së këtyre detyrimeve.

Në vijimësi

5. Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në DPT të shqyrtojë proceset e punës dhe të analizojë ngarkesën e punës së personelit të mbledhjes me forcë, duke propozuar mundësitë automatizimit për rritjen e efektivitetit të punës së këtyre strukturave.

Brenda vitit 2017

6. DPT të marrë masat përkatëse për përshtatjen e sistemit elektronik C@ts për të krijuar mundësinë e nxjerrjen **së të dhënave** sipas kërkesave dhe specifikave të punës së strukturave të mbledhjes me forcë, të nevojshme për analizat dhe raportet e menaxhimit si dhe që lejon ndjekjen e detyrimeve të papaguara tatimore në mënyrë më eficiente.

Brenda vitit 2017

7. Të zbatohet rregullisht metoda e vlerësimit të riskut nga strukturat e mbledhjes me forcë, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, duke parandaluar krijimin e detyrimeve të papaguara me vlera të vogla, në mënyrë që të maksimalizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.

Në vijimësi

8. DPT duhet të forcojë procedurat e kontrollit ndaj DRT në lidhje me menaxhimin e detyrimeve të papaguara tatimore si në drejtim të mbajtjes dhe evidentimit të dhënave në mënyrë unike, sistematike dhe të përditësuara ashtu edhe në zbatimin e masave shtrënguese në kohë dhe në përputhje me kuadrin rregullator.

Në vijimësi

9. Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në DPT të sigurojë kontroll të përhershëm për mbledhjen me forcë dhe të monitorojë vazhdimisht aktivitetet dhe rezultatet e arritura në punën e drejtorive rajonale, në mënyrë që t'i ofrohet DPT informacion të përditësuar mbi funksionimin e sistemit të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara në afat, duke **ushtruar periodikisht inspektime, për njohjen e gjendjes, dhënien e ndihmës dhe lënien e rekomandimeve për strukturat e mbledhjes me forcë.**

Në vijimësi

B. - Në drejtim të efektivitetit të masave shtërnguese të marra nga organet tatimore ndaj subjekteve tatimpagues me detyrimeve të papaguara në afat:

10. Përdorimin e metodave që do të sigurojnë pagesa vullnetare të detyrimeve të papaguara me qëllim shmangien e fillimit të zbatimit të masave shtrënguese. Këto metoda të cilat

konsistojnë edhe me vizitat në subjekte me detyrime të papaguara, përveç njoftimeve shkresore, nga ana e strukturave pëgjegjëse, duke vepruar menjëherë me krijimin e detyrimeve, pasi sa më shumë kohë kalon mundësitë për arkëtim zvogëlohen.

Në vijimësi

11. Drejtoritë Rajonale të hartojnë plane pune për të dërguar në sektorin e borxhit të gjitha Njoftim-Vlerësimet sipas detyrimeve që kanë në SIT tatimpaguesit me qëllim fillimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimeve.

Në vijimësi

12. Sektorët e mbledhjes me forcë të krijojnë dosje të veçanta për subjektet që rezultojnë pa procedura dhe fillimin menjëherë të tyre si dhe kompletimin e të gjithë dosjeve të tjera me dokumentacionin ligjor.

Menjëherë

13. Për tatimpaguesit të cilët rezultojnë me aktivitet import-eksporti të kryhen procedurat dhe të vendosen menjëherë “Urdhër Bllokimi në Doganë” deri në shlyerjen e detyrimeve që i kanë administratës tatimore.

Sektorët e mbledhjes me forcë të hartojnë marrëveshjet për pagesa me këste në përputhje të plotë me elementët e kërkuar.

Në vijimësi

14. Drejtoritë e Kontrollit Tatimor gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, përpara se të lenë detyrime ndaj subjekteve tatimpagues të analizojnë riskun e mundësisë së arkëtitimit të detyrimit përkatës për të parandaluar krijimin e një borxhi të pambledhshëm si dhe të ushtrojnë kompetencat ligjore në ndihmë të strukturave të mbledhjes me force në mbledhjen e borxhit tatimor.

Në vijimësi

15. DPT të ndërmarrë nismën për rishikimin e dispozitave ligjore e nënligjore që kanë lidhje me zbatimin në praktikë të realizimit të procedurës së sekuestrimit e më pas konfiskimit, të pasurisë së paluajtshme.

Menjëherë

16. DPT të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore, për ngritjen e një strukture të veçantë pranë DPT Tiranë, e cila të merret vetëm me zbatimin e procedurës së sekuestrimit e më pas konfiskimit, të pasurisë së paluajtshme, për kalimin në pronësi të administratës tatimorë të pasurive, duke vijuar me zbatimin e procedurave të Ankandit Publik, ku të ardhurat e përfituara, do të shkojnë për likuidimin e detyrimeve tatimore të papaguara nga ana e tatimpaguesit.

Menjëherë

17. DPT të ndërmarrë hapat e nevojshëm administrative – ligjor për lidhjen e marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet shtetërore të cilat janë përfshirë në kuadrin ligjor, ku të përcaktohen qartë detyrat konkrete, për të bërë të mundur realizimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese në mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

Menjëherë

18. DPT të rrisë ndërveprimet elektronik dhe shkëmbimit të informacionit me institucionet shtetërore dhe bankat e nivelit të dytë, duke përfshirë ndërtimin e një database me të dhëna të subjekteve tatimpagues me detyrime tatimore të papaguara, që të jetë i aksesueshëm online nga të gjitha institucionet shtetërore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për marrjen e masave shtrënguese përkatëse ndaj këtyre subjekteve.

Në vijimësi

19. Administrata tatimore të organizojë seminare e trajnime, për mbledhjen me force të detyrimeve tatimore të papaguara në afat për punonjësit e administratës tatimore dhe të organizatave profesionale tatimore të tatimpaguesve, në funksion të informimit dhe edukimit të tatimpaguesve.

Në vijimësi

20. DPT të analizojë detyrimet tatimore të papaguara në afat me vlera të vogla dhe t'i propozojë MF nxjerrjen e një Udhëzimi ku të përcaktohet kufiri i këtyre vlerave të detyrimeve tatimore të papaguara në afat “jo ekonomike për t'u mbledhur” dhe në këto kushte të mos evidentohen si borxh tatimor.

Brenda vitit 2017

21. DPT të vlerësojë efektivitetin e kostos së proceseve të ndryshme të mbledhjes me forcë në mënyrë që të administrojë burimet me efektivitet dhe të përcaktojë mundësitë e përmirësimit të këtyre proceseve.

Brenda 10 muajorit 2017

22. Administrata Tatimore duhet të intensifikojë aktivitetet në futjen e masave parandaluese të cilat duhet të kenë ndikim në lindjen e borxhit tatimor në përputhje me praktikatat pozitive të organeve tatimore të vendeve të zhvilluara.

Në vijimësi

23. Drejtoria e mbledhjes me forcë të hartojë dhe t'i propozojë drejtorit të përgjithshëm udhëzime apo vendime teknike për problematike të ndryshme të dala gjatë veprimtarisë së kësaj drejtorie dhe DRT-ve, të cilat do të përmirësonin punën në drejtim të menaxhimit të detyrimeve tatimore të papaguara në afat.

Në vijimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R